

Të huajt në Shqipëri, 2023

Tiranë, më 23 Gusht 2024: Në fund të vitit 2023, numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri rezultoi 21.460 banorë, duke pësuar rritje me 18,2 %, krahasuar me vitin 2022.

Numri i të huajve me leje qëndrimi dominohet nga meshkujt me 63,8 %, kundrejt femrave me 36,2 %. Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri në vitin 2023 ishte 12.430 aplikime, duke shënuar një rritje me 22,7 %, krahasuar me vitin 2022.


Të huajt me origjinë nga Kosova, Italia dhe Turqia përbëjnë numrin më të madh të të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri në vitin 2023, respektivisht me 3.712, 3.375 dhe 1.693 banorë.

Të huajt me origjinë nga Evropa rezultojnë 15.223 banorë në vitin 2023 dhe përbëjnë 70,9 % të të huajve gjithsej, kundrejt 73,3 % që përbënin në 2022.

Punësimi është arsyeja kryesore e lejeve të qëndrimit të të huajve në Shqipëri në 2023 me 48,3 %. Në vitin 2023 janë evidentuar 6.630 të huaj të parregullt në territorin e vendit, ku pjesën më të madhe të tyre, rreth 44,0 %, e zënë të huajt me origjinë nga Afganistani dhe Siria.

Fig. 1: Të huajt me leje qëndrimi sipas gjinisë, 2014 - 2023

(në mijë)



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT


Për publikim 23/08/2024

Vijon

Të huajt në Shqipëri

Gjatë vitit 2023, numri i të huajve me leje qëndrimi përbëhet nga 13.691 meshkuj dhe 7.769 femra. Grup-mosha dominante e të huajve me leje qëndrimi është 30-39 vjeç, e cila përbën 22,5 % të të huajve gjithsej me leje qëndrimi.

Fig. 2: Piramida e popullsisë së huaj rezidente në Shqipëri sipas grup-moshave kryesore



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pëpunimi INSTAT


Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2023 ishte 12.430 aplikime, duke shënuar një rritje me 22,7 %, krahasuar me vitin 2022. Aplikimet sipas vendit të origjinës nga Kosova dhe Italia përbëjnë 28,5 % të aplikimeve gjithsej në 2023.

Tab. 1: Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës 2022-2023

Vendi i origjinës	2022	2023
Itali	2.064	2.201
Kosovë	2.073	1.343
Turqi	782	1.142
SHBA	252	298
Egjipt	276	480
Filipine	272	472
Maqedoni e Veriut	171	212
Bangladesh	203	726
Siri	181	214
Tjetër	3.792	5.342
Gjithsej	10.127	12.430

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pëpunimi INSTAT

Fig.3: Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri, sipas afatit të qëndrimit, 2023




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit , përpunimi INSTAT

Të huajt në Shqipëri sipas kontinenteve

Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës kryesohen në vitin 2023 nga vendet e Evropës, duke zënë 70,9 % të të huajve gjithsej. Të huajt me origjinë nga Evropa janë 15.223 persona, duke shënuar një rritje me 14,5 %, krahasuar me 2022. Të huajt me origjinë nga Azia janë 3.784, duke shënuar një rritje me 43,3 %, krahasuar me 2022. Të huajt me origjinë nga Amerika, Afrika dhe Oqeania janë 2.453, duke pësuar një rritje me 10,8 %, krahasuar me vitin 2022.

Fig.4: Të huajt me leje qëndrimi sipas kontinenteve, 2014 - 2023




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit , përpunimi INSTAT

Të huajt në Shqipëri sipas vendit të origjinës

Në vitin 2023, të huajt me origjinë nga Kosova janë 3.712 banorë, duke shënuar një rritje me 31,2 %, krahasuar me 2022, ndërsa të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri me origjinë nga Italia janë 3.375 banorë, duke shënuar një rritje me 14,5 %, krahasuar me 2022.

Fig.5 Të huajt në Shqipëri sipas 5 vendeve kryesoretë origjinës, 2023




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT

Të huajt në Shqipëri sipas arsyes

Në vitin 2023 të huajt me leje qëndrimi për arsye punësimi zënë 48,3 % të të huajve gjithsej, ndjekur nga arsyet për bashkim familjar me 22,2 %, arsyet të tjera me 13,3 %, arsyet për qëllime humanitare me 12,4 % dhe arsyet për studime 3,7 %.

Fig.6 Të huajt me leje qëndrimi sipas arsyes, 2023



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT.


Te të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri me origjinë nga Italia, përveç arsyes për punësim (49,0 %) vihen re edhe një dominim i arsyes për studim (17,7 %).

Të huajt me origjinë nga Kosova kryesohen nga arsyet për bashkim familjar (43,5 %) dhe arsyet të tjera (32,4 %).

Të huajt me origjinë nga Turqia kryesohen nga arsyet për punësim (71,1 %) dhe arsyet për bashkim familjar (25,8 %).

Të huajt me origjinë nga SHBA dhe India dominohen nga arsyet për punësim, respektivisht me (62,6 % dhe 95,7 %).

Fig. 7: Të huajt me leje qëndrimi sipas vendit të origjinës dhe arsyes, 2023




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pëpunimi INSTAT

Të huajt e parregullt

Të huajt e parregullt të evidentuar në territorin e Shqipërisë ose në kufi, pa dokumentacionin e nevojshëm rezultojnë 6.630 persona në 2023, kundrejt 8.335 personave në 2022.


Fig. 8: Të huajt e parregullt, 2019 - 2023



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT.

Të huajt e parregullt sipas vendit të origjinës në 2023 kryesohen nga vende si Afganistani me 1.610 persona, Siria me 1.305 persona, Pakistani me 969 persona, Bangladeshi me 792 persona, Somalia me 475 persona dhe Maroku me 156 persona.

Fig. 9: Të huajt e parregullt, sipas vendeve kryesore të origjinës, 2019 - 2023



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT.

Metodologjia

Qëllimi i publikimit vjetor i të huajve në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grup-moshave dhe gjinisë, arsyes së aplikimit, vendeve të origjinës si dhe numrin vjetor të aplikimeve të lejeve të qëndrimit. Publikimi gjithashtu paraqet dhe të huajt e parregullt.

Të dhëna mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt sigurohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Përkufizime

I huaj është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Leje qëndrimi është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.

Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

Leje pune është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.

Bashkim familjar është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.

Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuetit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundin objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.

Shërbimi vullnetar është një program aktivitetesh solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.

Studiues dhe specialistë janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.

Qëndrim i parregullt është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.